




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 29.07.2019

Ref.: 1362/130

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 19.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

- I. Akreditohet Kolegji Universum në nivelin institucional, për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
- II. Akreditohet programi i studimit për periudhën 3 vjeçare, 1 tetor 2019 – 30 shtator 2022.
 - Diplomaci, MA, 120, ECTS, maksimumi 50 studentë për vit akademik;
- III. Obligohet Kolegji Universum që deri me datë 1 Tetor 2019 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna në raportin final të ekspertëve ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

Kolegji Universum ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA), për akreditim institucional dhe të programeve të studimit:

AKA ka organizuar vizitën 11 qershor 2019, me qëllim të vlerësimit të institucionit dhe të programeve të studimit të cekura me sipër me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, me këtë përbërje: Prof. Dr. Milan Pol dhe Prof. Dr. Vlatko Cvrtila.


Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 19 qershor 2019 dhe 15 korrik 2019 ka shqyrtuar raportin final të ekspertëve ndërkombëtar për Kolegjin Universum, dhe pas shqyrtimit të

rekomandimeve përfundimtare, të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Kolegji i Universum
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni

Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë